



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë : " **Adnan Bislimi B.I. " me seli në Skenderaj**, Autoriteti Kontraktues - Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjekt në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën **15.08.2023**, merr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e eliminuar, të subjektit në procedurë: " **Adnan Bislimi B.I. " me seli në Skenderaj**, në procedurën prokurimit me titull: " **Ndërtimi i rrugës me zhavorr në fsh. Karaçë – Shilovicë dhe fsh. Dumnicë " Prok: VU644 – 23 – 6572 -5-2-1 / Nr. i brendshëm : VU644 – 23 – 078 – 521**
2. Vërtetohet si i bazuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues - Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 07.08.2023

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues - Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që, për arsye se gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime të cilat në masë substanciale tejkalojnë buxhetin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit në fjalë dhe në zbatim të nenit 62 pika 2 paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, aktiviteti i prokurimit lidhur me projektin në fjalë të **ANULOHET**

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesit pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit janë dërguar për publikim në platformën elektronike me dt. 07.08.2023, bazuar në dispozitat e nenit 43 të Rregullores mbi Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se, duke vendosur si në Vendimin e dt. 07.08.2023, A.K. ka shkelur dispozitat e LPP-së, konkretisht nenin 65 të LPP-së, Kërkesat lidhur me pranueshmërinë e Përshtatshmërisë.

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi pretendimi e Ankuesit të parashtruar në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë, për arsye se:

1. Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Sipas nenit 1 të LPP-së, A.K. ka pasur për qëllim që, bazuar në kushtet dhe rregullat e specifikuara, procedurën e zbatuar, të siguroj mënyrën më efikase më transparente dhe më të drejtë të realizoi shfrytëzimin e fondeve publike dhe burimeve publike të A.K. Neni 7 ka pasur për qëllim trajtimin e barabartë, pa diskriminuar asnjë prej O.E. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dh krahasimi i tenderëve) lidhur me nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 (**tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët**) ka pasur për qëllim, që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimit dhe vlerësimi të tenderëve, të vendosë në mënyrë meritore. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se **Vendimi i A.K. i dt. 07.08.2023** është marrë bazuar në kushtet, rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent. Vendimi për ta anuluar aktivitetin e prokurimit në fjalë është marrë në mes tjerash edhe në zbatim të 62 pika 2 paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe

plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe pas njoftimit gjegjësisht konfirmimit nga Njësia Kërkuese e A.K. se nuk ka mjete financiare shtesë për mbulimin e diferencës së mjeteve financiare nga çmimi imë i ulët i tenderit të përgjegjshëm, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përbushë kërkesat administrative/ të përshtatshmërisë, profesionale dhe minimalisht ato teknike dhe / ose profesionale të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

3. Sa i përket pretendimit të Ankuesit se A.K. në mënyrë të gabuar është bazuar në interpretimin e KRPP-së nr. 64 të dt. 17.04.2019 lidhur me periudhën kohore kur një O.E. duhet të jetë i "Pranueshëm", A.K. konstaton se një pretendim i tillë i Ankuesit është i pa bazuar, sepse sikurse sqaron A.K., një O.E. duhet të jetë gjithmonë i "Pranueshëm" në kuptim të dispozitave të nënti 65 paragrafi 5 të LPP-së para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

Më tej, sikurse ka konstatuar A.K., mbi bazën e të dhënave nga aktiviteti i prokurimit në fjalë rezulton se Njoftimi për Kontratë, në platformën elektronike, është publikuar më dt. 30.06.2023 ndërsa Marrëveshja për pagesë të borxheve tatimore me këste "ATK Nr. 9923 në emër të anëtarit të Grupit të O.E. "Adnan Bislimi B.I." është lidhur më dt. 06.07.2023. Rrjedhimisht, bazuar dhe në interpretimin e Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik nr. 64 dt. 17.04.2019, më tej KRPP, tenderi i Ankuesit është vlerësuar si i pa pranueshëm sepse, citat: "Nisur nga fakti se shumë O.E. kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në rastin konkret, marrëveshja për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit për kontratë" mbarim i citatit, që në rastin konkret Marrëveshja e Ankuesit është lidhur pas datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë dhe, rrjedhimisht dokumentin si të tillë e bënë jo të rregullt, të papranueshëm dhe në kundërshtim me interpretimin e KRPP-së, ndërsa Ankuesin e vlerëson si O.E. të pa pranueshëm pasi që nuk i përbushë Kërkesat e Pranueshmërisë, në kuptim të nenit 65 paragrafi 5 të LPP-së, që ndërlidhet me periudhën kohore kur O.E. duhet të jetë i "Pranueshëm".

4. Lidhur me pretendimin e Ankuesit se interpretimi i KRPP-së mbi çështjen se kur një O.E. duhet të jetë i Pranueshëm/Përshtatshëm në kuptim të nenit 65 të LPP-së është i shfuqizuar më dt. 01.11.2022 dhe si i tillë interpretimi nuk është valid dhe A.K. nuk mund të thirret / bazohet në këtë interpretim, A.K. konstaton se një argument i tillë nuk është i saktë. Dispozitat e nenit 65 të LPP-së lidhur me "Pranueshmërinë" e O.E. nuk zbatohen në mënyrë selektive, të njëjtat nuk janë ndryshuar dhe / ose plotësuar. Interpretimi i KRPP-së, sikurse vlerëson A.K. nuk është i shfuqizuar, këtë më së miri e sqaron dispozita e nenin 102 e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, se cilat rregullore shfuqizohen me hyrjen në fuqi të Rregullores në fjalë. 5. Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit janë të pabazuara, të pasakta dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Përfundimisht, A.K. vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit si ai i dt. 07.08.2023 për të anuluar aktivitetin e prokurimit në fjalë nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, me theks të veçantë neni 7 - Barazia në trajtim/ Jo diskriminimi dhe 59 parag.4 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve dhe nenin 65 i LPP-së lidhur me "Pranueshmërinë/Përshtatshmërinë" e O.E., andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë të pasakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 të Rregullave për paraqitje të kërkesë për rishqyrtim, A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


Udhëzim Juridik: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në OSHP, në pajtim me dispozitat e nenit 109 të LPP-së lidhur me nenin 9 të Rregullave për parashtrimin e ankesës pran OSHP-së.

Autoriteti Kontraktues - Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
K.R. nr. 078/2023 - datë: 15. 08.2023

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1x DKP
3. 1 x Arkiviti (1 kopje)

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik



Alban Tahiraj